



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Qershor 2022

Prishtinë, 12.07.2022: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në shtator të vitit 2002 deri në muajin dhjetor 2015, ndërsa nga muaji janar 2016 është harmonizuar sipas konceptit ndërkombëtar dhe publikohet si Indeks i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Çmimet e konsumit kanë filluar të mbliidhen në muajin maj të vitit 2002 i cili konsiderohet muaji bazë. Nga muaj janar i vitit 2016 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) bazuar në rekomandimet e Eurostatit publikohet me vitin bazë 2015=100 dhe janë rillogaritur mbi këtë bazë të gjitha seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) përkatësisht Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në vend dhe janë të publikuara në Ueb-faqen e ASK-ës (në publikimin vjetor të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit 2002 - 2021). Çmimet konsumit mbliidhen prej datës 10 deri 20 të muajit në 14 Komuna të Kosovës. ASK nga muaji shtator i vitit 2002 në vazhdimësi ka publikuar në baza mujore IÇK - IHÇK dhe tetëmbëdhjetë publikime në baza vjetore (2004 - 2021).

Ky publikim përmban tabelën me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Kosovë në baza mujore janar 2010 – Qershor 2022, mesatarja vjetore 2010-2021 (2015=100), me ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje, paraqitja grafike, tabelën për peshat specifike, indeksin për muajin qershor 2022, ndryshimet mujore dhe vjetore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Qershor 2022 / Maj 2022) dhe (Qershor 2022 / Qershor 2021) për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it, tabelën me çmime mesatare për disa artikuj të konsumit dhe metodologjinë e llogaritjes së indekseve të harmonizuara të çmimeve të konsumit.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën e ueb infoask@rks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ismajl Sahiti - Zv. Drejtor i Departamentit

Ibish Asllani - Shef i Divizionit

Saranda Berisha – Zyrtare

Korrik, 2022

Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-ës
Ilir T. Berisha

Për t'u konsultuar me publikime të tjera, vizitoni faqen e ASK: <http://ask.rks-gov.net>

Simbolet dhe Shkurtesat

| | |
|--------|---|
| IÇK | Indeksi i Çmimeve të Konsumit |
| COICOP | Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit |
| ABF | Anketa e buxhetit familjar |
| LLK | Llogaritë Kombëtare |
| IHÇK | Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| : | Shifra nuk është disponibël |
| 0 | Më pak se gjysma e njësisë së përdorur |
| - | Nuk aplikohet |
| % | Përqindje |
| ‰ | Promil |
| W | Ponderët statistikor (pesha specifike – IÇK/IHÇK) |
| Ø | Mesatare |

Përmbajtja

| | Faqe |
|---|------|
| Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Qershor 2022 | 4 |
| Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje | 5 |
| Fig. 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2021 (2015=100)..... | 8 |
| Fig. 2: Normat vjetore dhe mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it..... | 8 |
| Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it..... | 9 |
| Tab. 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit..... | 11 |
| Shpjegime metodologjike | 12 |

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Qershor 2022

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 1,4% në muajin qershor 2022. Norma vjetore e inflacionit e matur në muajin qershor 2022 me muajin qershor 2021 ishte 14,1%.

Qershor 2022 / Maj 2022 1,4%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,4% në muajin qershor 2022 krahasuar me muajin maj 2022. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (1,1%), mishi (1,4%), pemët (3,0%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (2,2%), kafja, çaji dhe kakao (2,3%), pijet alkoolike (1,5%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (6,0%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (1,8%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (15,4%), shërbimet për transport (5,9%), pushime të organizuara (4,1%), shërbimet hoteliere (2,3%), kujdesi personal (1,5%) si dhe disa nëngrupe tjera me një ndikim të vogël, e që të gjitha patën një ndikim të përbashkët prej 1,9 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: qumështi, djathi dhe vezët (-1,6%), perimet (-10,9%), energjia elektrike (-0,7%) *((për shkak të rënies së konsumit (shpenzimeve) të energjisë elektrike në muajin qershor 2022 krahasuar me muajin maj 2022))* me një ndikim prej -0,5 për qind në IHÇK-it.

Qershor 2022 / Qershor 2021 14,1%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 14,1 për qind në muajin qershor 2022 krahasuar me muajin qershor 2021. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (27,7%), mishi (19,6%), qumështi, djathi dhe vezët (22,3%), vajrat dhe yndyrat ushqimore (53,8%), perimet (6,8%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (19,0%), prodhime të ndryshme ushqimore salca, erëza kripë, ushqim për fëmijë etj. (12,8%), kafja, çaji dhe kakao (17,9%) uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (6,2%), pijet alkoolike (7,0%), duhani (4,8%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (11,0%), gazi (39,3%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (33,6%), mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (5,7%) pajisje shtëpiake (8,9%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (12,1%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (9,5%), produktet farmaceutike (4,0%), blerja e automjeteve (6,8%), pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (6,7%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (67,3%), shërbimet për transport (18,9%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (5,4%), shërbimet hoteliere (12,6%), kujdesi personal (6,7%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 14,3 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: pemët (-8,4%), energjia elektrike (-0,9%) *((për shkak të rënies së konsumit (shpenzimeve) të energjisë elektrike në muajin qershor 2022 krahasuar me muajin qershor 2021))* me një ndikim prej -0,2 për qind në IHÇK-it.

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje

| Muaji\Viti | Indeksi (2015 = 100) | Inflacioni mujor % | Inflacioni vjetor % |
|-------------------------------|----------------------|-----------------------|------------------------|
| Jan - 2010 | 88,0 | 0,6 | 0,7 |
| Shk - 2010 | 88,2 | 0,2 | 1,1 |
| Mar - 2010 | 88,1 | -0,1 | 0,8 |
| Pri - 2010 | 87,2 | -1,0 | 1,6 |
| Maj - 2010 | 87,5 | 0,3 | 2,2 |
| Qer - 2010 | 87,6 | 0,1 | 2,2 |
| Korr - 2010 | 87,9 | 0,3 | 2,7 |
| Gush - 2010 | 90,5 | 3,0 | 6,0 |
| Shtat - 2010 | 90,8 | 0,3 | 6,0 |
| Teto - 2010 | 91,9 | 1,2 | 6,0 |
| Nën - 2010 | 92,3 | 0,4 | 6,2 |
| Dhje - 2010 | 93,2 | 1,0 | 6,5 |
| Mesatarja vjetore 2010 | 89,4 | : | 3,5 |
| Jan - 2011 | 94,5 | 1,4 | 7,4 |
| Shk - 2011 | 96,5 | 2,1 | 9,4 |
| Mar - 2011 | 97,6 | 1,1 | 10,8 |
| Pri - 2011 | 96,5 | -1,1 | 10,7 |
| Maj - 2011 | 96,5 | 0,0 | 10,3 |
| Qer - 2011 | 95,7 | -0,8 | 9,2 |
| Korr - 2011 | 95,2 | -0,5 | 8,3 |
| Gush - 2011 | 95,3 | 0,1 | 5,3 |
| Shtat - 2011 | 95,1 | -0,2 | 4,7 |
| Teto - 2011 | 96,2 | 1,2 | 4,7 |
| Nën - 2011 | 96,2 | 0,0 | 4,2 |
| Dhje - 2011 | 96,5 | 0,3 | 3,5 |
| Mesatarja vjetore 2011 | 96,0 | : | 7,4 |
| Jan - 2012 | 97,3 | 0,8 | 3,0 |
| Shk - 2012 | 98,2 | 0,9 | 1,8 |
| Mar - 2012 | 98,3 | 0,1 | 0,7 |
| Pri - 2012 | 97,6 | -0,7 | 1,1 |
| Maj - 2012 | 97,6 | 0,0 | 1,1 |
| Qer - 2012 | 97,3 | -0,3 | 1,7 |
| Korr - 2012 | 97,3 | 0,0 | 2,2 |
| Gush - 2012 | 98,3 | 1,0 | 3,1 |
| Shtat - 2012 | 99,1 | 0,8 | 4,2 |
| Teto - 2012 | 99,9 | 0,8 | 3,8 |
| Nën - 2012 | 99,5 | -0,4 | 3,4 |
| Dhje - 2012 | 100,1 | 0,6 | 3,7 |
| Mesatarja vjetore 2012 | 98,4 | : | 2,5 |
| Jan - 2013 | 100,7 | 0,6 | 3,5 |
| Shk - 2013 | 100,8 | 0,1 | 2,6 |
| Mar - 2013 | 100,8 | 0,0 | 2,5 |
| Pri - 2013 | 100,0 | -0,8 | 2,5 |
| Maj - 2013 | 99,7 | -0,3 | 2,2 |
| Qer - 2013 | 99,9 | 0,2 | 2,7 |
| Korr - 2013 | 99,6 | -0,3 | 2,4 |
| Gush - 2013 | 99,5 | -0,1 | 1,2 |
| Shtat - 2013 | 99,3 | -0,2 | 0,2 |
| Teto - 2013 | 100,1 | 0,8 | 0,2 |
| Nën - 2013 | 100,3 | 0,2 | 0,8 |
| Dhje - 2013 | 100,6 | 0,3 | 0,5 |
| Mesatarja vjetore 2013 | 100,1 | : | 1,7 |

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)

| Muaji\Viti | Indeksi (2015 = 100) | Inflacioni mujor % | Inflacioni vjetor % |
|-------------------------------|----------------------|-----------------------|------------------------|
| Jan - 2014 | 100,9 | 0,3 | 0,2 |
| Shk - 2014 | 100,9 | 0,0 | 0,1 |
| Mar - 2014 | 101,1 | 0,2 | 0,3 |
| Pri - 2014 | 100,3 | -0,8 | 0,3 |
| Maj - 2014 | 100,2 | -0,1 | 0,5 |
| Qer - 2014 | 100,3 | 0,1 | 0,4 |
| Korr - 2014 | 100,4 | 0,1 | 0,8 |
| Gush - 2014 | 100,4 | 0,0 | 0,9 |
| Shtat - 2014 | 100,6 | 0,2 | 1,3 |
| Teto - 2014 | 100,7 | 0,1 | 0,6 |
| Nën - 2014 | 100,4 | -0,3 | 0,1 |
| Dhje - 2014 | 100,2 | -0,2 | -0,4 |
| Mesatarja vjetore 2014 | 100,5 | : | 0,4 |
| Jan - 2015 | 100,3 | 0,1 | -0,6 |
| Shk - 2015 | 100,6 | 0,3 | -0,3 |
| Mar - 2015 | 100,7 | 0,1 | -0,4 |
| Pri - 2015 | 99,9 | -0,8 | -0,4 |
| Maj - 2015 | 99,7 | -0,1 | -0,5 |
| Qer - 2015 | 99,9 | 0,1 | -0,4 |
| Korr - 2015 | 99,6 | -0,2 | -0,8 |
| Gush - 2015 | 99,7 | 0,1 | -0,7 |
| Shtat - 2015 | 99,4 | -0,3 | -1,2 |
| Teto - 2015 | 100,0 | 0,6 | -0,7 |
| Nën - 2015 | 100,1 | 0,1 | -0,3 |
| Dhje - 2015 | 100,0 | 0,0 | -0,2 |
| Mesatarja vjetore 2015 | 100,0 | : | -0,5 |
| Jan - 2016 | 100,5 | 0,4 | 0,1 |
| Shk - 2016 | 100,7 | 0,2 | 0,0 |
| Mar - 2016 | 100,8 | 0,1 | 0,1 |
| Pri - 2016 | 99,8 | -1,0 | -0,1 |
| Maj - 2016 | 99,6 | -0,2 | -0,1 |
| Qer - 2016 | 99,6 | -0,1 | -0,3 |
| Korr - 2016 | 99,6 | 0,0 | 0,0 |
| Gush - 2016 | 99,8 | 0,2 | 0,0 |
| Shtat - 2016 | 99,9 | 0,2 | 0,6 |
| Teto - 2016 | 100,9 | 0,9 | 0,9 |
| Nën - 2016 | 101,0 | 0,1 | 0,9 |
| Dhje - 2016 | 101,3 | 0,4 | 1,3 |
| Mesatarja vjetore 2016 | 100,3 | : | 0,3 |
| Jan - 2017 | 102,2 | 0,8 | 1,7 |
| Shk - 2017 | 102,3 | 0,2 | 1,7 |
| Mar - 2017 | 102,3 | -0,1 | 1,5 |
| Pri - 2017 | 102,0 | -0,3 | 2,2 |
| Maj - 2017 | 101,2 | -0,8 | 1,5 |
| Qer - 2017 | 101,5 | 0,3 | 1,9 |
| Korr - 2017 | 101,3 | -0,2 | 1,7 |
| Gush - 2017 | 101,5 | 0,2 | 1,7 |
| Shtat - 2017 | 101,6 | 0,1 | 1,7 |
| Teto - 2017 | 101,8 | 0,2 | 0,9 |
| Nën - 2017 | 101,8 | 0,1 | 0,9 |
| Dhje - 2017 | 101,8 | 0,0 | 0,5 |
| Mesatarja vjetore 2017 | 101,8 | : | 1,5 |

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)

| Muaji\Viti | Indeksi (2015 = 100) | Inflacioni mujor % | Inflacioni vjetor % |
|-------------------------------|----------------------|--------------------|---------------------|
| Jan - 2018 | 102.0 | 0.2 | -0.2 |
| Shk - 2018 | 102.3 | 0.3 | 0.0 |
| Mar - 2018 | 102.4 | 0.1 | 0.1 |
| Pri - 2018 | 102.4 | 0.0 | 0.4 |
| Maj - 2018 | 102.2 | -0.2 | 1.0 |
| Qer - 2018 | 102.3 | 0.1 | 0.8 |
| Korr - 2018 | 102.5 | 0.2 | 1.2 |
| Gush - 2018 | 103.0 | 0.4 | 1.5 |
| Shtat - 2018 | 103.1 | 0.1 | 1.4 |
| Teto - 2018 | 103.3 | 0.2 | 1.5 |
| Nën - 2018 | 103.9 | 0.7 | 2.1 |
| Dhje - 2018 | 104.8 | 0.8 | 2.9 |
| Mesatarja vjetore 2018 | 102.8 | : | 1.1 |
| Jan - 2019 | 105.2 | 0.4 | 3.1 |
| Shk - 2019 | 105.6 | 0.4 | 3.2 |
| Mar - 2019 | 105.7 | 0.1 | 3.3 |
| Pri - 2019 | 105.9 | 0.1 | 3.4 |
| Maj - 2019 | 105.7 | -0.2 | 3.4 |
| Qer - 2019 | 105.3 | -0.3 | 3.0 |
| Korr - 2019 | 105.2 | -0.1 | 2.6 |
| Gush - 2019 | 105.7 | 0.5 | 2.7 |
| Shtat - 2019 | 105.6 | -0.1 | 2.4 |
| Teto - 2019 | 105.5 | 0.0 | 2.2 |
| Nën - 2019 | 105.7 | 0.2 | 1.7 |
| Dhje - 2019 | 106.0 | 0.2 | 1.2 |
| Mesatarja vjetore 2019 | 105.6 | : | 2.7 |
| Jan - 2020 | 106.8 | 0.8 | 1.5 |
| Shk - 2020 | 106.6 | -0.2 | 1.0 |
| Mar - 2020 | 106.5 | -0.1 | 0.7 |
| Pri - 2020 | 106.2 | -0.3 | 0.3 |
| Maj - 2020 | 105.9 | -0.3 | 0.2 |
| Qer - 2020 | 105.4 | -0.4 | 0.1 |
| Korr - 2020 | 105.1 | -0.3 | -0.1 |
| Gush - 2020 | 105.2 | 0.1 | -0.5 |
| Shtat - 2020 | 105.1 | -0.1 | -0.4 |
| Teto - 2020 | 105.3 | 0.2 | -0.2 |
| Nën - 2020 | 105.4 | 0.1 | -0.3 |
| Dhje - 2020 | 106.1 | 0.6 | 0.1 |
| Mesatarja vjetore 2020 | 105.8 | : | 0.2 |
| Jan - 2021 | 106.6 | 0.5 | -0.2 |
| Shk - 2021 | 107.4 | 0.7 | 0.7 |
| Mar - 2021 | 107.8 | 0.4 | 1.2 |
| Pri - 2021 | 108.2 | 0.3 | 1.9 |
| Maj - 2021 | 107.9 | -0.2 | 2.0 |
| Qer - 2021 | 107.9 | 0.0 | 2.4 |
| Korr - 2021 | 108.8 | 0.8 | 3.5 |
| Gush - 2021 | 110.1 | 1.2 | 4.7 |
| Shtat - 2021 | 110.2 | 0.1 | 4.9 |
| Teto - 2021 | 111.3 | 1.0 | 5.7 |
| Nën - 2021 | 112.7 | 1.2 | 6.9 |
| Dhje - 2021 | 113.2 | 0.5 | 6.7 |
| Mesatarja vjetore 2021 | 109.3 | : | 3.4 |
| Jan - 2022 | 114.2 | 0.9 | 7.1 |
| Shk - 2022 | 115.5 | 1.1 | 7.5 |
| Mar - 2022 | 118.6 | 2.7 | 10.0 |
| Pri - 2022 | 120.3 | 1.5 | 11.2 |
| Maj - 2022 | 121.4 | 0.9 | 12.5 |
| Qer - 2022 | 123.1 | 1.4 | 14.1 |

Fig. 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2021 (2015=100)





Fig. 2: Normat vjetore dhe mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it

| COICOP | Grupet dhe nëngrupet | Peshat 2022 në % | VI - 2022 2015=100 | VI - 2022 V- 2022 | VI - 2022 VI - 2021 |
|-------------|---|---------------------|-----------------------|----------------------|------------------------|
| 00 | Gjithsej IHÇK | 1000.0 | 123.1 | 1.4 | 14.1 |
| 01 | Ushqimi dhe pijet joalkoolike | 395.7 | 130.2 | -0.3 | 17.6 |
| 01.1 | Ushqimi | 337.2 | 132.6 | -0.3 | 19.2 |
| 01.1.1 | Buka dhe drithërat | 89.5 | 148.9 | 1.1 | 27.7 |
| 01.1.2 | Mishi | 93.6 | 132.8 | 1.4 | 19.6 |
| 01.1.3 | Peshqit | 4.1 | 116.5 | 1.1 | 5.9 |
| 01.1.4 | Qumështi, djathi dhe vezët | 57.9 | 130.8 | -1.6 | 22.3 |
| 01.1.5 | Vajrat dhe yndyrnat | 10.1 | 208.8 | 0.9 | 53.8 |
| 01.1.6 | Pemët | 23.3 | 91.7 | 3.0 | -8.4 |
| 01.1.7 | Perimet | 34.7 | 106.9 | -10.9 | 6.8 |
| 01.1.8 | Sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat | 13.7 | 132.3 | 2.2 | 19.0 |
| 01.1.9 | Prodhimet ushqimore | 10.3 | 121.2 | 0.5 | 12.8 |
| 01.2 | Pijet joalkoolike | 58.5 | 118.5 | 0.1 | 8.5 |
| 01.2.1 | Kafja, çaji dhe kakao | 13.1 | 150.2 | 2.3 | 17.9 |
| 01.2.2 | Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet | 45.4 | 111.0 | -0.5 | 6.2 |
| 02 | Pijet alkoolike, duhani | 60.7 | 127.1 | 0.6 | 5.6 |
| 02.1 | Pijet alkoolike | 23.6 | 118.5 | 1.5 | 7.0 |
| 02.2 | Duhani | 37.1 | 134.7 | 0.0 | 4.8 |
| 03 | Veshje dhe këpucë | 41.9 | 102.7 | 0.2 | 0.3 |
| 03.1 | Veshje | 31.1 | 101.8 | 0.3 | 0.2 |
| 03.2 | Këpucë | 10.8 | 105.3 | 0.0 | 0.9 |
| 04 | Strehimi , uji, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera | 73.3 | 110.4 | 1.0 | 9.9 |
| 04.1 | Pagesa aktuale për banim | 5.5 | 97.2 | 0.0 | -0.3 |
| 04.3 | Mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit | 7.5 | 117.1 | 1.5 | 10.6 |
| 04.4 | Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin | 10.4 | 100.8 | 0.0 | 1.4 |
| 04.5 | Energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera | 49.9 | 111.3 | 1.2 | 13.1 |
| 04.5.1 | Energjia elektrike | 28.3 | 89.1 | -0.7 | -0.9 |
| 04.5.2 | Gaz | 3.8 | 153.0 | -3.1 | 39.3 |
| 04.5.4 | Lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. | 15.6 | 153.5 | 6.0 | 33.6 |
| 04.5.5 | Energjia termike | 2.2 | 91.8 | 0.0 | 0.0 |
| 05 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 75.1 | 110.4 | 0.6 | 6.9 |
| 05.1 | Mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje | 16.7 | 106.5 | -0.3 | 5.2 |
| 05.2 | Tekstile shtëpiake | 3.2 | 100.2 | -0.5 | 2.6 |
| 05.3 | Pajisje shtëpiake | 13.7 | 110.2 | 0.1 | 7.6 |
| 05.4 | Qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës | 13.6 | 106.4 | 0.0 | 1.7 |
| 05.5 | Veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht | 12.5 | 118.1 | 1.5 | 12.1 |
| 05.6 | Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake | 15.4 | 114.5 | 1.8 | 9.2 |

Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Qershor 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it (vazhdim)

| COICOP | Grupet dhe nëngrupet | Peshat 2022 në % | VI - 2022 2015=100 | VI - 2022 V - 2022 | VI - 2022 VI - 2021 |
|-------------|--|---------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|
| 06 | Shëndetësia | 25.7 | 112.1 | 0.5 | 2.6 |
| 06.1 | Produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje | 14.6 | 112.4 | 0.7 | 3.1 |
| 06.1.1 | Produktet farmaceutike | 11.6 | 112.9 | 0.5 | 4.0 |
| 06.1.2 | Produkte të tjera mjekësore | 0.8 | 109.4 | 1.6 | 3.4 |
| 06.1.3 | Pajisjet terapeutike | 2.2 | 113.1 | 1.5 | -0.8 |
| 06.2 | Shërbimet ambulatore | 9.6 | 113.2 | 0.2 | 2.3 |
| 06.3 | Shërbimet spitalore | 1.5 | 100.5 | 0.0 | 0.5 |
| 07 | Transporti | 159.1 | 136.4 | 7.3 | 30.5 |
| 07.1 | Blerja e automjeteve | 58.1 | 107.2 | -0.3 | 6.3 |
| 07.2 | Përdorimi i pajisjeve për transportin personal | 79.5 | 160.6 | 12.3 | 51.9 |
| 07.2.1 | Pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal | 10.6 | 107.8 | 1.0 | 6.7 |
| 07.2.2 | Karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal | 59.5 | 175.0 | 15.4 | 67.3 |
| 07.2.3 | Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit | 4.0 | 116.5 | 0.0 | 5.6 |
| 07.2.4 | Shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit | 5.4 | 137.1 | 0.0 | 9.9 |
| 07.3 | Shërbimet për transport | 21.5 | 123.4 | 5.9 | 18.9 |
| 08 | Mjetet e komunikimit | 36.2 | 115.4 | 0.2 | 0.7 |
| 08.1 | Shërbimet postare | 2.5 | 104.6 | 0.0 | 0.0 |
| 08.2 | Pajisjet telefonike dhe të telefaksit | 4.6 | 84.2 | 1.2 | 3.7 |
| 08.3 | Shërbimet telefonike dhe të telefaksit | 29.1 | 121.6 | 0.0 | 0.4 |
| 09 | Rekracioni dhe kultura | 41.5 | 100.2 | 0.2 | 2.1 |
| 09.1 | Pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave | 10.4 | 87.5 | -1.8 | 0.2 |
| 09.2 | Pajisjet tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë | 1.5 | 103.7 | 0.3 | 2.9 |
| 09.3 | Gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret | 7.3 | 107.1 | 0.2 | 5.4 |
| 09.4 | Shërbimet rekreative dhe kulturore | 5.5 | 103.1 | 0.0 | 1.5 |
| 09.5 | Gazetat, librat dhe materialet për zyra | 10.5 | 102.8 | 0.1 | 2.2 |
| 09.6 | Pushime të organizuara | 6.3 | 106.6 | 4.1 | 1.3 |
| 10 | Arsimi | 12.7 | 102.6 | 0.0 | 1.6 |
| 11 | Restorantet dhe hotelet | 35.7 | 121.3 | 2.1 | 11.8 |
| 11.1 | Shërbimet hoteliere | 32.6 | 122.4 | 2.3 | 12.6 |
| 11.2 | Shërbimet për strehim | 3.1 | 113.8 | 0.0 | 4.1 |
| 12 | Mallrat dhe shërbimet e ndryshme | 42.4 | 112.8 | 0.7 | 4.0 |
| 12.1 | Kujdesi personal | 15.5 | 112.5 | 1.5 | 6.7 |
| 12.3 | Gjërat personale | 7.8 | 114.8 | 0.9 | 5.8 |
| 12.4 | Mbrojtja sociale | 0.7 | 113.5 | 1.8 | 3.4 |
| 12.5 | Sigurimet | 7.2 | 122.4 | 0.0 | 0.2 |
| 12.6 | Shërbimet financiare | 8.9 | 107.1 | 0.0 | 1.8 |
| 12.7 | Shërbimet tjera | 2.3 | 99.4 | 0.0 | 0.0 |

Tab. 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit

| Kodi | Artikujt | Njësia matëse | VI 2021 | V 2022 | VI 2022 |
|-------|------------------------------------|------------------|---------|--------|---------|
| 101 | Oriz | 1 kg | 1.42 | 1.44 | 1.46 |
| 102 | Miell gruri | 1 kg | 0.52 | 0.78 | 0.79 |
| 103 | Bukë e bardhë | 500 gr | 0.36 | 0.46 | 0.46 |
| 111 | Mish gjedhi pa eshtra | 1 kg | 6.65 | 7.96 | 8.20 |
| 112 | Mish viçi | 1 kg | 7.45 | 8.90 | 8.94 |
| 114 | Mish pule | 1 kg | 2.64 | 3.71 | 3.78 |
| 131 | Qumësht (Tetrapak) | 1 lit | 0.91 | 1.08 | 1.09 |
| 133 | Jogurt | 1 lit | 0.89 | 1.04 | 1.06 |
| 137 | Vezë | 30 copë | 1.92 | 3.25 | 2.78 |
| 141 | Vaj ushqimor luledielli | 1 lit | 1.56 | 2.78 | 2.80 |
| 151 | Mollë | 1 kg | 1.07 | 0.84 | 1.02 |
| 152 | Dardhë | 1 kg | 1.74 | 1.66 | 1.86 |
| 153 | Banane | 1 kg | 1.18 | 1.30 | 1.31 |
| 155 | Limon | 1 kg | 1.33 | 1.23 | 1.43 |
| 161 | Patate | 1 kg | 0.54 | 0.82 | 0.68 |
| 162 | Domate | 1 kg | 0.83 | 1.70 | 1.03 |
| 163 | Fasule | 1 kg | 2.59 | 2.78 | 2.82 |
| 167 | Speca të pa djegës | 1 kg | 0.92 | 1.66 | 1.11 |
| 175 | Sheqer | 1 kg | 0.70 | 0.98 | 1.03 |
| 192 | Kafe e bluar | 1 kg | 9.44 | 11.34 | 11.61 |
| 193 | Çaj | 1 kg | 7.77 | 8.39 | 8.44 |
| 195/1 | Uji natyral pa gaz | 1.5 lit | 0.31 | 0.34 | 0.34 |
| 196 | Coca cola | 2 lit | 1.30 | 1.36 | 1.35 |
| 197 | Lëng pemësh | 1 lit | 0.89 | 0.94 | 0.94 |
| 204 | Birrë | 0.5 lit | 0.66 | 0.70 | 0.71 |
| 216 | Cigare - Ronson | 1 pako | 1.78 | 1.88 | 1.88 |
| 217 | Cigare - Marlboro | 1 pako | 2.79 | 2.89 | 2.89 |
| 416 | Energja elektrike (Pa kosto fikse) | 1 kwh | 0.058 | 0.057 | 0.057 |
| 418 | Dru zjarri | 1 m ³ | 38.53 | 48.27 | 51.52 |
| 701 | Benzin | 1 lit | 1.08 | 1.55 | 1.86 |
| 702 | Dizel | 1 lit | 1.05 | 1.67 | 1.86 |

Shpjegime metodologjike

Përkufizime

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) i Kosovës, i prodhuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është i përpiluar sipas metodave të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Eurostatit e ka definuar IHÇK si standard Evropian për indekset e çmimeve të konsumit. Indeksi i kalkuluar dhe rezultatet e tyre prezantohen përmes Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), klasifikim ky ndërkombëtarë i cili klasifikon konsumin në Divizione, Grupe dhe Klasa artikujsh. Sipas COICOP-it, ASK ka ndarë 91 klasa konsumi të definuar (në nivel 4-shifror) më tutje në 420 produkte (agregat elementarë). ASK ka përcaktuar peshë për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë.

Çdo muaj IHÇK kalkullohet në dy hapa:

1. Indekset elementarë (treguesit për agregat elementarë) llogariten nga çmimet e grumbulluara duke përdorur formulën e mesatares gjeometrike të papeshuar (të Jevon-it).
2. Indekset e nivelit më të lartë, dukë përfshirë vetë IHÇK, llogariten dukë nxjerrë mesataren e indekseve elementarë përmes formulës së mesatares aritmetike të peshuar (tipi i Laspajerit (Laspeyres)).

Peshat elementare të agreguara janë bazuar në vlerësimet e shpenzimeve të konsumit vjetor. ASK për 91 klasa konsumi bën vlerësimin e shpenzimeve të konsumit vjetor nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare (LLK), peshat brenda klasave të konsumit vijnë nga burimet e brendshme të ASK-së. Peshat specifike nga janari 2013, ishin të bazuara në vlerësimet e të dhënave të Anketës së Buxhetit Familjar dhe Llogarive Kombëtare që i referohen vitit 2012. Nga janari i vitit 2015 peshat specifike të rifreskuara bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2013. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike për artikuj dhe shërbime të harmonizuara sipas E-coicop (rekomandime nga Eurostatit) bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2014. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2015. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2016. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2017. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2018. Nga janari i vitit 2021 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2019. Rifreskimi i peshave çdo vit, siguron se IHÇK reflekton trendët aktuale të konsumit.

Të gjitha blerjet monetare të bëra në vend (brenda vendit) nga sektori i ekonomive familjare definohen si gjithsej shpenzimet e konsumit vjetor. Ky definicion përputhet me kategorinë e LLK të quajtur Konsumi Final Monetar i Ekonomive Familjare (HFMC) dhe nënkupton se peshat duhet të përfshijnë vlerën e konsumit të produkteve vetanake dhe koston e banimit nga vetë pronari.

Deri në dhjetorin e vitit 2014 peshat kanë përfshi shpenzimet vetëm për konsumatorët rezident, ndërsa nga janari i vitit 2015 përfshihen edhe shpenzimet për konsumatorët jo rezident.

Për të vlerësuar ndryshimet mujore të çmimeve, stafi i ASK mbledh çmime për një numër të artikujve specifik (shpesh të quajtur shporta e tregut) të zgjedhura si përfaqësim i agregateve elementar. Qëllimi është që të mblidhen të gjitha çmimet, pikërisht artikujve të njëjtë për çdo muaj; kurdo që një çmim nuk ka mundësi të mblidhet, atëherë procedurat e llogaritjes duhet të aplikohen me kujdes për t'iu shmangur rezultatit të gabuar.

Grumbulluesit e të dhënave pranë ASK-së, me seli në shtatë qendra rajonale (zyre rajonale statistikore), mbledhin përafërsisht mbi 6800 çmime gjatë periudhës nga data 10-20 të çdo muaji referues. Çmimet mblidhen në supermarkete, ndërmarrje shërbyese, dyqane, tregje dhe pika tjera të shitjes me pakicë në katërbëdhjetë komuna të Kosovës:

- Gjakovë
- Gjilan
- Istog
- Kaçanik
- Kamenicë
- Mitrovicë
- Rahovec
- Pejë
- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Suharekë
- Ferizaj
- Vushtrri

Stafi i zyrës qendrore të ASK-së në Prishtinë mbledh çmimet për artikuj dhe shërbime si rryma, uji, shërbimet postare dhe telekomunikacioni, për transportin ajror dhe hekurudhor .

Indekset Elementar

Indeksi elementar për një muaj është i barabartë me indeksin e tij në muajin paraprak të shumëzuar me ndryshimin e çmimit të matur për një muaj, i llogaritur nga çmimet e grumbulluara. ASK përdor formulën e mesatares gjeometrike (apo të Jevon-it) për të llogaritur ndryshimet njëmuajore: shkalla e mesatares gjeometrike të muajit aktual në mesataren gjeometrike të çmimeve të mbledhura për muajin e kaluar.

Indeksi i agregatit elementar e për muajin m

- = Indeksi i çmimit për agregatin elementar e për muajin m
- = Indeksi i çmimit për agregatin elementar e për muajin m-1
- = Çmimi për artikullin i në muajin m
- = Çmimi për artikullin i në muajin m-1
- = Numri i çmimeve të mbledhura për agregatin elementar e

Indekset e Nivelit më të Lartë

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdor formula e Young-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhurnuara me ndryshmet e çmimeve. (Formula e Lowe-it është e përafërt me formulat aktuale të Laspeyres).

Të dy formulat, si formula e Young-ut dhe ajo e Lowe-it janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të Laspeyres. Aktualisht IHÇK përdor formulën e Lowe-it për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdor formula e Young-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhurnuara me ndryshmet e çmimeve. (Formula e Lowe-it është e përafërt me formulat aktuale të Laspeyres).

Të dy formulat, si formula e Young-ut dhe ajo e Lowe-it janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të Laspeyres. Aktualisht IHÇK përdor formulën e Lowe-it për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë periudhës së peshuar viti 2010. Peshat e reja nga të dhënat e LLK dhe ABF- vitit 2012 janë aplikuar nga janari i vitit 2014. IÇK ka kaluar në kalkulimin e indekseve me formulën Lowe-it; (peshat kanë qenë pjesë e shpenzimeve të vitit 2012 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2013. Nga janari i vitit 2015 janë aplikuar peshat specifike nga të dhënat e LLK dhe ABF

të vitit 2013 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2014. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2014 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2015. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2015 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2016. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2016 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2017. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2017 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2018. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2018 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2019.

Peshat e Indeksit

Formula e Young Peshon Agregatet Elementare brenda Grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b}{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b = 1$$

$w_{e,g}^b$ = Pesha për agregat elementarë **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese **b**

x_e^b = shpenzimet për agregatin elementar **e** në periudhën peshuese **b** (Aktualisht **b** = 2012)

k_g = Numri i agregateve elementare në grupin **g**

Formula e Young peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{g=1}^h w_g^b = 1$$

w_g^b = Pesha për grupin **g** në periudhën peshuese **b**

h = Numri i grupeve në ICK

Formula e Lowe-it peshon agregatet elementare brenda grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v}}{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b = 1$$

$w_{e,g}^b$ = Pesha për agregat elementar **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese **b**
(Në përdorim nga Janari 2014, **b** = 2012)

$a_e^{b \rightarrow v}$ = faktor rregullues i peshave për agregatet elementar **e**

$$a_e^{b \rightarrow v} = I_e^v / \frac{1}{12} \left(\sum_{m=Jan}^{Dec} I_e^{m/b} \right)$$

I_e^v = Indeksi i çmimit për agregate elementar **e** për muajin **v**
(Në përdorim nga Janari 2014, **v** = Dhjetor 2013)

$$I_e^{m/b} = \text{Indeksi i çmimeve për agregat elementarë } e \text{ në muajin } m \text{ në vitin } b$$

Formula e Lowe peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$W_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{g=1}^h W_{e,g} = 1$$

Indekset për Grupet e niveleve më të larta

$$I_g^m = \sum_{e=1}^{k_g} W_{e,g}^b * I_e^m \quad I_e^0 = 100$$

Për shumicën e artikujve periudha **0** është Maj 2002 , por kjo periudhë ndryshon për sipas inkuadrimit të artikujve të përfshirë më vonë

IHÇK i tërësishëm

IHÇK i tërësishëm është një mesatare aritmetike e peshuar e indekseve të grupeve. Në IHÇK është përdor formula e *Young-it*, por që nga Janari i vitit 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it.

Për shkak se nëngrupet kanë baza të ndryshme indeksesh (shumica kanë për bazë Maj 2002=100, por grupet e shtuara më vonë kanë bazë tjetër, nga janari i vitit 2016 indekset janë të kalkuluar me vitin bazë 2015=100), indekset e grupeve duhet të ri bazohen në një periudhë të përbashkët, që është muaji **v** (muaji paraprak para së të vihen në përdorim peshat e reja).

$$HICP^m = HICP^v \times \sum_{\xi=1}^h W_{\xi}^b \times \frac{I_{\xi}^m}{I_{\xi}^v} \quad HICP^0 = 100$$

$HICP^m$ = Indeksi i harmonizuar i çmimit të konsumit për muajin **m**

v = muaji paraprak para së të përdoren peshat e reja (Aktualisht **v** = Dhjetor 2020)

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.